

VENDIM
Nr.96, datë 21.2.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.236, DATË 10.5.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E FURNIZIMIT ME UJË PËR PËRDORUESIT
FAMILJARË DHE JOFAMILJARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.236, datë 10.5.1993 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Konsumatorët jofamiljarë, shtetërorë ose privatë, që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë, administrojnë dhe ruajnë vetë matësit e ujit. Në rast dëmtimi konsumatori jofamiljar duhet të njoftojë, me shkrim, ndërmarrjen e ujësjellësit dhe të marrë masa për ta zëvendësuar matësin e ujit, brenda 30 ditëve. Paga e konsumit të ujit për këtë periudhë bëhet në bazë të normave të konsumit mesatar mujor të konsumatorit. Nëse ndërmarrja e ujësjellësit nuk njoftohet për dëmtimin e matësit ose matësi nuk vendoset brenda afatit të caktuar, konsumatori (jofamiljar) detyrohet të paguajë konsumin mesatar të ujit me 5-fishin e çmimit.”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në rast se konsumatori nuk paguan detyrimin, që ka ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit, në bazë të kontratës për furnizimin me ujë, detyrohet të paguajë një shtesë për kamatëvonesë 0.5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 për qind.

Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditësh, ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë.

Shpenzimet e kryera nga ndërmarrja e ujësjellësit, për rilidhjen e konsumatorit me rrjetin e furnizimit me ujë, të përballohen nga konsumatori.”.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha